

VENDIM
Nr. 46, datë 7.3.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË
PAJTUESHMËRISË SË OST SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 54, pika 6 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, nenit 19, pika 1, germa “f”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe vendimit të bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.”, në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, ka miratuar certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.

- Në vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, të bordit të ERE-s, është parashikuar që Programi i Pajtueshmërisë duhet t’i dorëzohet autoritetit rregullator ERE, jo më vonë se 6 muaj pas caktimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. Ndërkohë që Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të caktohet jo më vonë se 3 muaj pas miratimit të vendimit final të certifikimit.

- Me vendimin nr. 147, datë 28.9.2017, bordi i ERE-s ka vendosur për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të propozuar nga OST sh.a.

- Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë OST sh.a., me vendimin nr. 2, datë 21.1.2018, ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së OST sh.a.

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 962 prot., datë 31.1.2018, i është drejtuar ERE-s me kërkesën për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.

- Ky Program ka si qëllim të sigurojë:

- Ndarjen e duhur dhe pavarësinë e OST-së;

- Të shmangë sjelljet diskriminuese të OST-së ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike (këtu dhe më poshtë – “pjesëmarrësit”) dhe përdoruesve të rrjetit;

- Prezantimin e një mekanizmi për zbatimin e këtij Programi dhe përcaktimi i detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OST-së në lidhje me këtë Program;

- Prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sh.a., Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi